

RAPORTI PARAPRAK
I
VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT:
“Rritja e shpendeve per tregetim”



Subjekti: “Agri Zoo” sh.p.k

Vendndodhja: Fier Ri, Qarku Fier

Pergatiti materialin : “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k

Tirane, 2016

PERMBAJTJA

- + Hyrje
- + Baza ligjore
- + Metodika e vleresimit te mjedisit
- + Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

- Qellimi dhe karakteristikat fizike te projektit
- Vendndodhja e aktivitetit
- Pershkrimi I projektit

2. PERSHKRIMI I TEKNOLOGJISE

3. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

4. VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

- Ndikimet ne popullsi
- Ndikimet ne klime
- Ndikimi nga zhurmat
- Ndikimi nga shkarkimet e ujerave
- Ndikimet ne toke
- Ndikimet ne cilesine e ajrit

5. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

- Gjelberimi i territorit
- Masat ndaj mbetjeve te ngurta
- Grumbullimi i ujerave
- Kushtet e punes
- Mbrojtja nga insektet dhe brejtesit
- Ndricimi i objektit
- Mbrojtja nga zjarri

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

+ HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Rritja e shpendeve per tregtim ”

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

Kur parametrat mjedisore nuk jane konform ligjeve, normave dhe rregullave te mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje te tij dhe prishje te ekuilibrave natyror.

Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana e organeve legislative dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

Ne kete raport *Vleresimi Ndikimi ne Mjedis* eshte trajtuar aktiviteti:

“Rritja e shpendeve per tregtim ”

+ BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*

- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 'Per metodologjine e raportit te VNM'*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ **Profili i propozuesit**

Subjekti "Agri Zoo"sh.p.k eshte rregjistruar prane QKR me numer NIPT-ti **K34004401E** Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte ne Fier i Ri, Qarku Fier.

Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore te Tipit B sipas *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja. »*

1.5 Vendndodhja

Subjekti "Agri Zoo" sh.p.k do e ushtroje aktivitetin e tij ne Fier i Ri, Qarku Fier.



2- PERSHKRIMI I TEKNOLOGJISE

2.1 Etapat e rritjes se zogjve

- *Njohja me ambientin me te cilin rritet zogu*

Ambienti me te cilin rritet zogu eshte nje magazine ekzistuese. Per te plotesuar kushtet per rritjen e zogjve ne lokale eshte vendosur nje impiant uji i perbere nga tre linja uji, nje impiant per ushqimin e zogjve i perber nga 2 linja ushqimi te kompletuara me pjata dhe me panelin e komanduar automatik, tre linja me ndricues, ventilatoret per qarkullimin e ajrit , aparati i matjes se temperatures dhe paneli elektrik i kontrollit me anen e te cilit behet komandimi ne menyren e duhur e te gjitha proceseve.

- *Pergatitja e lokalit per prritjen e zogjve*

Etapa e pare e pergatitjes se lokalit eshte pastrimi i tij nga mbetjet (plehu) e tufes se pare, me pas behet larja e lokalit, proces te cilit i kushtohet nje rendesi e vecante. Lokali pasi eshte pastruar dhe lare lihet te thahet per disa dite, me pas behet izolimi mbyllja e dritareve, dyerve, aspiratoreve ne menyre qe dizinfektimi te behet sa me mire dhe te japi rezultate sa me pozitive. Pasi kane mbaruar keto procese behet dezinfektimi i ambientit ne menyre te imtesishme dhe ne sasine e duhur te dizinfektantit dhe lokalit lihet i mbyllur per 24 ore.

- *Pritja e zogut*

Duke u mbeshtetur dhe ne kushtet klimaterike hapja e lokalit behet 1 ose 2 dite para mberritjes se zogut. Gjate kesaj kohe behet ngrohja e lokalit me ane te ngroheseve qe jane kryesisht me gaz, pergatitja e rrethakeve dhe vendosja e piresve te ujit dhe kupave te ushqimit brenda ne rrethak. Gjithashtu behet larja e linjave te ujit dhe me pas ato lihen te mbushura me uje me sode gje e cila ndihmone ne pastrimin e linjave te ujit dhe ne heqjen e mbeturinave.

- *Pershtatja e aparaturave sipas moshes se zogjve*

Ne ditet e para zogu ushqehet si e permendem me siper me pas rreth dites se 3 zogu hiqet nga rrethakja dhe uji thithet ne menyre automatike me ane te linjave te ujit duke lene dhe disa pires shtese ndersa zogu te mesohet te pije uje ne linja. Menyra e ushqimit vazhdon e njejte si ditet e pare deri ne moshen 10-15 ditesh, me pas vendosen linjat automatike te ushqimit. Pra zogu ushqehet sipas deshires. E rendesishme ne rritjen e tyre eshte temperatura dhe ventilimi.

- *Pergatitja e ushqimit dhe perberesit kryesor te tij*

Nje pike e rendesishme ne realizimin me sukses te kesaj veprimtarie eshte edhe ushqimi. Perberesit kryesor jane misri dhe soja. Rreth 80 % te ushqimit e perben misri, soja perben 28 % dhe pjesa tjeter perbehet nga vaji, karbonat dhe nukleusi qe i nevojitet zogut per te marr sasine e duhur te proteinave, energjise dhe gjithcka qe i nevojitet per nje rritje pa probleme. E rendesishme nuk eshte vetem perberja e ushqimit por edhe madhesia e kokrres se ushqimit. Ne periudhen e pare deri ne 21 dite kokrra e ushqimit duhet te jete shume e vogel, me pas ushqimi behet me i ashper ne menyre qe zogu mund ta konsumoj pa probleme.

- **Rregullat per mbrojtjen nga faktoret e jashtem**

Rendesi e vecante i kushtohet mbrotjes nga faktoret e jashtem per kete perdoret ajo qe quhet karantine, domethen nuk lejohet kalimi i punetoreve dhe materialeve te ndryshem nuk lejohet hyrja e makinave te huaja ne territorin e kompleksit. Makinat perpara se te futen ne kete ambient u behet nje dezinfektim me sperkatje.

3. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

3.1 Gjeologjia e rajonit

Ne kete rajon kemi te bejm me tokat e hirta e te kafta , keto toka jane formuar mbi shkembinj argjilor te neogjenit. Kane profile te diferencuara me ngjyre te hirte te kuqerremte, perberje mekanike subargjilore te mesme ne te rende. Perberja kimike e tyre tregon se jane mestarisht te pasura me humus. Persa i perket elementeve ushqyes te asimilueshme nga bimet keto toka paraqiten te varfere me azot dhe fosfor dhe te pasura ne patos.

3.2 Trashegimia arkitektonike

Aktiviteti qe kryhet nuk prek zonat turistike, zona te mbrojtura, zona arkeologjike, arkitektonike, objekte te trasheguara dhe te ndertuara nga njeriu me rendesi historike, sepse ne kete zone ato nuk ekzistojne. Eshte per t'u theksuar se ne kete zone nuk ka monumente kulture, zona arkeologjike dhe gjeomonamente.

3.3 Flora dhe fauna

Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë zona dallohet për disa lloje bimesh e kafshesh sidomos ne pjeset bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshesh si urithi, cakalli, nusja e lales, dhelpra, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje te ndryshëm zvarranikesh e gjarprinjs. Ndërsa ne ujerat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Zona bën pjese ne brezin e shkurreve dhe te pyjeve mesdhetare. Shkurret perbehen nga nenkati I makies, ku rriten shkurret me gjelberim te perhershem si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Ne këtë nenkat bimor rriten edhe disa drure te lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, qe ne disa raste formojne pyje te vegjel.

3.4 Klima

Zona ku do zhvillohet aktiviteti ka klime mesdhetare fushore. Ajo karakterizohet nga dimer i bute e i lagesht dhe vere e nxehte dhe e thate. Reshjet e rena jane ne forme shiu dhe rralle bore e cila ka nje kohezgjatje te vogel. Temperatura mesatare me e larte eshte ne muajin korrik, gusht 23 °C, dhe me e uleta ne muajin Janar 7.2 °C. Ndryshimi i lageshtise relative te ajrit gjate vitit eshte i lidhur ngushte me ecurine e temperatures se ajrit. Vlerat me te larta te lageshtise jane ne periudhen e ftohte te vitit ndersa me te uleta ne periudhen e ngrohte te tij.

4. VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

I gjithë objekti është i lidhur me një sistem kanalizimesh për ujërat e bardha dhe të zeza të ambienteve dhe këto të fundit janë të lidhura me sistemin kanalizimeve të zonës industriale.

4.1 Ndikimet ne popullsi

Vendi ku do të zhvillohet aktiviteti është relativisht larg qendrave të banuara dhe nuk sjell shqetësime për ta vecse rrit mundësinë e punësimit të tyre, duke rritur kështu nivelin ekonomik të këtyre familjeve. Zhvillimi i këtij aktiviteti ka për të mundur kthimin e një zone të pashfrytëzuar në një zonë ku do të zhvillohet një aktivitet që do të sjell të mira e shërbime jo vetëm për investitorin por edhe për komunitetin.

4.2 Ndikimet ne klime

Gjate zhvillimit të projektit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të përmirësimit ashtu edhe në atë të përkeqësimit të saj. Nuk do të ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Për kryerjen e këtij aktiviteti nuk ndikon fare në kushtet klimaterike të kësaj zone.

4.3 Ndikimet nga zhurmat

Zhurmat që krijohen janë si rezultat i lëvizjes së makinave të transportit, zhurma të tjera nuk ka gjatë zhvillimit të aktivitetit.

4.4 Ndikime nga shkarkimi i ujerave

Gjate zhvillimit të proceseve të larjes së lokaleve pasi ndërrohen grupet e zogjve, ujërat e përdorur dekantohen në gropa të posaçme përpara se të shkarkohen në kanalizime. Në këto ujëra nuk ka shkarkime të lëngëta të rrezikshme. Përse i përket ujërave të reshjeve si atyre të përdorimit nga personeli ato i bashkohen kanalizimit kryesor të zonës.

4.5 Ndikimet ne toke

Gjate zhvillimit të aktivitetit nuk gjenerohen mbetje të ngurta të cilat të përbejnë rrezik për ndotjen e tokës, jashtëqitjet e zogjve pasi trajtohen në kompleks shkojnë për përdorim të pleherimit të tokës nga ana e fermerëve. Mbetjet që gjenerohen nga aktiviteti i përgjithshëm i personelit shkon në vendet e caktuara nga pushteti lokal.

4.6 Ndikimet ne ajer

Gjate zhvillimit të aktivitetit nuk kemi aktivitet prodhues që të gjeneroj gaze në atmosferë, përse nuk do të ketë ndikime negative në ajër si rezultat i këtij aktiviteti. Përse i përket aromave të pakëndeshme nga ana e investitorit është për të mundur mbjelljen e territorit përreth lokaleve me lule dekorative dhe gjelberim të përhershëm.

5. MASAT PËR ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

Kërkesat mjedisore që synojnë mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit, përfshijnë specifikimin e kushteve, normave e standarteve të detyrueshme për mbrojtjen e pastërtisë së ajrit urban, të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, të cilësisë e vlerave të tokës, të territoreve urbane, rrugëve, trotuareve, zonave të gjelbëruara. Projekti që do të zbatohet nga shoqëria e ndertimit merr në konsideratë të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar ndikimet e

mundeshme negative qe krijohen gjate fazes se rikonstruksionit te rrugeve. Gjithashtu edhe drejtues te subjektit i cili do te vihet ne shfrytezim, do te marrin ne konsiderate te gjitha masat lehtesuese zbutese per ndikimet ne mjedis.

5.1 Gjelberimi i territorit

Per eleminimin e aromave te pakendeshme nga ana e shoqerise eshte ber e mundur gjelberimi i siperfaqes me lule dekorative dhe gjelberim te perhershem.

5.2 Mbetjet e ngurta

Mbetjet e ngurta qe gjenerohen jane jashteqitjet e shpendeve te cilat pasi trajtohen ne kompleks shkojne per per dorim nga ana e fermerëve per pleherimin e tokave bujqesore.

Mbetjet qe gjenerohen nga aktiviteti njerezor shkon ne vendin e caktuar nga pushteti lokal.

5.3 Grumbullimi ujerave

Ujerat te cilat dalin nga pastrimi i lokaleve perpara se te shkarkohen ne kanal in kryesor dekantohen ne gropen dekantuese, keto ujera nuk permbajne elemente kimike te rrezikshem per mjesisin ujqor prites. Ujerat e shiut drejtohen permes kanalizimeve drejt kolektorit kryesor sebashku me ujerat e perdorimit nga aktiviteti njerezor.

5.4 Masat per mbrojtjen nga insektet dhe brejtesit

Gjithashtu jane masat per mbrojtjen nga insektet dhe brejtesit brenda kapanonit dhe ne mjediset rreth tij. Per kete personeli mban paster dhe ben kontroll te shpesht te mjedisëve ku ruhen dritherat si dhe lendet e tjera ushqimore per shpendet. Gjithashtu per te shmangur kete fenomen eskrecionet largohen sistematikisht nga lokali.

5.5 Ndricimi i objektit

Furnizimi i objektit me rryme elektrike behet nga dy burime energjie, nga rrjeti elektrik i pushtetit lokal dhe ne raste avarie me motogjenorator.

Kabllo elektrike jane te vendosur ne tuba celiku per nje siguri me te larte dhe per te rritur masat ndaj zjarrit.

5.6 Mbrojtja nga zjarri

Ne zbatimin e gërmes b, te nenit 34, te Ligjit Nr.8766 date 05.04.2001 "Per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin", jane marre masat e nevojshme per mbrojtjen ne raste rreziku apo renie zjarri. Per nje siguri maksimale ne ambjentet e punes nga drejtuesit e saj, jane marre te gjitha masat per zbatimin e rregullave te sigurimit teknik dhe te mbrojtjes nga zjarri.

Brenda objektit jane vendosur ne vende te dukshme paisje te mbrojtjes nga zjarri, si dhe jane marre masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike.

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

+ KONKLUZIONE

- ✓ Gjatë zhvillimit të procesit të punës, bëhet pluhur i lehtë nga grimcat e ushqimit të pulave qe janë të imta, si rrjedhojë drejtuesit kanë marrë masa për paisjen e punëtoreve që punojnë pranë paisjeve të prodhimit, me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri, si kominoshe pune, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri.

- ✓ Investitori ka punuar në krijimin e një ambjenti sa më të sistemuar dhe të gjelberuar dhe në hyrjet e kompleksit është disiplinuar dhe monitorohen hyrje-daljet ne territorin e tij.
- ✓ Zhvillimi i aktivitetit nuk sjell ndotje te mjedisit, ujerat qe perdoren per larjene lokaleve tarjtohen dhe dekontojne para se te shkarkohen ne mjedisin uJOR prites.

REKOMANDIME

- Për të bërë të mundur disiplinimin e të gjithë ujrave dhe të ulet në maksimum impaktin në mjedis i tyre duhen pastruar ne menyre periodike gropat dekantuese.
- Të merren masa për të parandaluar rënien e zjarrit dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (depozite uji, zjarrefikëse të lëvizshme etj.)
- Për uljen e aromes së rëndë që lëshohet nga sekrementet e zogjve , sidomos kur kryhet procesi i larjes së lokaleve dyert duhen te jene te mbyllura.
- Te vazhdoje gjelberimi i territorit sidomos me peme me gjelberim të përherëshëm në perimetrin rrethues të saj.
- Te mbahet ne gadishmeri te plote sistemi me furnizimin e ujit te pijshem

- Te mbahet ne gadishmeri te plote dhe sistemi i grumbullimit dhe largimit te plehut qe krijohet

Per “EKO - STUDIO - PROJEKT” sh.p.k

Ing. Xhevair DERMYSHI

Ing.Majola QATJA